REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I MINISTRAVE**

# VENDIM

**Nr.** 253 **, datë** 27.3.2020

## PËR

## DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në listën e shkronjës "C", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida", shtohet individi i renditur në shkronjën "a", sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për persona që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida.

2. Në listën e shkronjës "D", të titulluar "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida", shtohen

vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për kompanitë që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-SË (LISTA E OKB-së)**

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANI-ZATAT ISIL (DA'ESH) DHE AL-QAIDA:

a) Lista e shtuar në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida":

**QDe.164 Name:** JAMAAH ANSHARUT DAULAH

D. LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË ME ORGANIZATAT ISIL (Da'esh) dhe AL-QAIDA

b) Lista e shtuar në "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida":

**QDe.165 Name:** ISLAMIC STATE IN IRAQ AND THE LEVANT - LIBYA
**QDe. 166 Name:** ISLAMIC STATE IN IRAQ AND THE LEVANT - YEMEN

Shënim: Gjenealitetet e tjera për personin emri i të cilit është renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.